



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

18027

UDHËZIM I POSAÇËM

28.12.15

Nr. 34, Datë 28/12/2015

“PËR
ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2016”

Në mbështetje të nenit 104 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 34 të Ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 “Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Ligjit nr. 147/2015 “Per buxhetin e vitit 2016”, ministri i Financave;

UDHËZON :

Meqenëse Ligji nr. 147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, dekretuar me dekretin e Presidentit nr. 9376, datë 24.12.2015, nuk ka hyrë në fuqi, deri në hyrjen në fuqi të tij, për të siguruar një proces normal të zbatimit të buxhetit vjetor udhëzoj:

1. Nëpunësi i Parë Autorizues të kryejë detajimin e buxhetit vjetor 2016 për të gjitha institucionet e qeverisjes së përgjithshme në sistemin informatik financiar të qeverisë, si dhe me anë të shkresave për shpenzimet korrente.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit nëpërmjet sistemit informatik financiar të qeverisë, të kryejë pagesa vetëm për:
 - a. Pagesat për shërbimin e borxhit;
 - b. Pagesat për shpenzime emergjente spitalore me funksion jetësor (blerje oksigjen, gjak, ushqim, etj);
 - c. Pagat e punonjësve të qeverisjes së përgjithshme dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;
 - d. Transferrat në Institucionin e Sigurimeve Shoqërore për pagesat e pensioneve;
 - e. Pagesë Paaftësie/Ndihma ekonomike/pagesë papunësie;
 - f. Pagesat për ushqim dhe medikamente për të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme që e ofrojnë një shërbim të këtij lloji.
3. Pagesat për njësitë e qeverisjes vendore do të fillojnë më 06.01.2016 për arsye të konfigurimeve të reja në sistemin informatik financiar të qeverisë.
4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

